

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE - ADMINISTRATIVE
ZYRA E ARKIVIT

Nr. 02 Prot

Gjirokastrë më, 06.01 .2025

URDHËR

Nr. 01 , datë 06 , 01 , 2025

“ PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË EKSPERTIZËS ”

Në zbatim të nenit 7 Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003 “ Për Arkivat ” si dhe neneve 32, 33, 34, 35 të “ Normave tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë ” dhe Vendimin Nr. 4 datë 19.06.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” neni 5 .

URDHËROJ :

Ngritjen e Komisionit të Ekspertizës, pranë Universitetit “ Eqrem Çabej ” i përbërë nga 9 (nëntë) anëtarë si më poshtë:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1. Prof.Dr. Jaho Cana | Kryetar |
| 2. Violeta Serjani | Anëtar |
| 3. Marianthi Xha | Anëtar |
| 4. Semi Golemi | Anëtar |
| 5. Borana Lelaj | Anëtar |
| 6. Kaltrina Meleqi | Anëtar |
| 7. Martin Zeko | Anëtar |
| 8. Klaviona Dudumi | Anëtar |
| 9. Vladimir Belaj | Anëtar |

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

PROF.DR. JAHO CANA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
REKTORI**

Nr. 04 prot.

Gjirokastrë, më 06.01.2025

URDHËR

Nr. 02 , datë 06.01.2025

**PËR
NJËSIMIN E DOKUMENTIT ADMINISTRATIV**

Në mbështetje dhe në zbatim të Nenit 11, pika b, të Ligjit Nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për Arkivat" dhe (ligjit specific) dhe Vendimit Nr.4, datë 19.06.2017 për miratimin e "Regullores së njësuar të punës me dokumentet publike të Republikës së Shqipërisë".

URDHËROJ:

1. Dokumentet administrative, të përpiluara sipas Normave Tekniko – Profesionale të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë në përputhje me modelet bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Siglimi i kopjes së dytë të dokumentave kryhen si më poshtë :
Konceptoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë , nënshkrimi i konceptuesit.*
Pranoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë , nënshkrimi i përgjegjës të Strukturës së nivelit të parë (nëse ka).*
Miratoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë , nënshkrimi i përgjegjës të Strukturës së nivelit të dytë (nëse ka).*
Konfirmoi: *Nistore e emrit, pikë, Mbiemri i Plotë, nënshkrimi i zëvendësuesit, Juristit apo pozicionit tjetër të përcaktuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit .*
3. Dokumentet të përpilohen me shkrim Times New Roman, me madhësi 12 dhe hapësira rreshtave të jetë 1.15, si dhe në anësore të lihen 3 cm bosh, ndërsa në krye e në fund të faqes nga 2 cm
4. Dokumentet të përpilohen në bazë të rregullave drejtshkrimore, ku të përdoren gërmat (ë) dhe (ç), si dhe kryeradhët.
5. Struktura të shënohet në dokumentet administrative vetëm në nivelin e strukturës më të lartë (Departamentit, Drejtorisë ose Sektorit sipas rastit) që ka konceptuar dokumentin. Titullari i institucionit është strukturë më vete, në rastin e dokumenteve të konceptuara nga ai dhe në këto dokumente shënohet si strukturë më vete, emertësa e titullarit, sipas organikës.

- 6 Përfashtimisht, në rastet kur dokumentet janë produktet e pozicioneve të posaçme të punës, të parashikuara në ligj dhe që nuk janë më vete, pozicionet shënohen poshtë strukturës perkatëse, ku ndodhet pozicioni i posaçem sipas rastit, Struktura Përgjegjëse për Sinjalizuesit, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të interesit, Koordinatori për të drejtën e Informimit, Njësia e Burimeve Nerëzore etj.
- 7 Njësia e Prokurimeve, Grupet ad – hoc të punës, Komisioni i Ekspertizës si dhe të gjitha njësitë e tjera të ngritura sipas ligjit specifik në nivelin më të lartë drejtues shënohen si nënstrukturë, poshtë strukturës me emërtesën e titullarit, sipas organikës së institucionit.
- 8 Sekretari – Arkivi i institucionit njofton titullarin në të gjitha rastet kur shkresat nuk përpilohen sipas këtij urdhëri.
- 9 Ngarkohen strukturat e institucionit, pozicionet e posatshme të punës sipas ligjit dhe Sekretari – Arkivi për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

PROF.DR JAHO CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 27 Prot.

Gjirokastrë, më 09.01./2024

U R D H Ë R

Nr. 03, datë 09.01.2025

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STAFIT QË DO TË PËRFSHIHET NË MOBILITETE NË
KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 30, Marrëveshjes Ndërinstitucionale, të nënshkruar nga autoritetet e IES Ribeira do Louro, Spanjë dhe Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si dhe "Thirrjes për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me institucionin arsimor Mestre Mateo Art & Design School, Spanjë", Nr. 1957 Prot., dt 18.12.2024,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit *ad hoc* për vlerësimin e dokumentacionit të stafit që do të përfshihet në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, me këtë përbërje:

- | | |
|------------------------------|----------|
| 1. Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| 2. Prof. asoc. Valbona Duri | Anëtar |
| 3. Msc. Irma Gjollëshi | Anëtare |

2. Ky komision do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga stafi akademik dhe administrativ i interesuar për mobilitet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, anëtarët e komisionit të përmendur në pikën 1.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jaho ~~CANA~~



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 52 Prot.

Gjirokastrë, më 13 / 01 / 2025

URDHËR

Nr. 04, datë 13.01.2025

PËR

PËRFUNDIM TË KONTRATËS SË PUNËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 pika 3, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si dhe neni 30 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1.Znj. **Alketa Rami**, deri më tani "Specialiste për Mësimin dhe Kurrikulat" në Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative, meqënëse i përfundoi kontrata e punës i ndërpriten efektet financiare më datë 15.01.2025.

4.Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike -Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho **CANI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 53 Prot.

Gjirokastrë, më 13/01 /2025

URDHËR

Nr. 05, datë 13.01.2025

PËR

PËR SHTYRJE TË AFATIT TË KONTRATËS

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë" i përditësuar neni 140 pika 1, gërma b, neni 150, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Satutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30 pika 2 Vendim nr. 422, datë 26.6.2024 për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit Të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetëse dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike",

URDHËROJ:

1. **Z. Aristomen Mandi** deri më tani në detyrë si Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme në Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë 6 (gjashtë) muaj, me kohë të pjesshme (4 orë në ditë) nga data 15.01.2025 deri më datë 14.07.2025
3. Kategoria e pagës do të jetë sipas Kreut I/1 me emërtesë teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme.
4. Klasa V, me pagë mujore 42 800 (dyzetë e dy mijë e tetëqindë) lekë.
5. Efektet financiare në vijushmëri.

Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 74 Prot.

Gjirokastrë, më 16 / 01 /2025

U R D H Ë R

Nr. 06, datë 16 . 01 .2025

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT ORGANIZATIV PËR
KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE QË UNIVERSITETI "EQREM
ÇABEJ" GJIROKASTËR DO TË ORGANIZOJË NË BASHKËPUNIM ME
UNIVERSITETIN KARAMANOGLU MEHMETBEY, TURQI**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma a, e pika 4, gërma c, neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Kreu IV, neni 30, Kreu IX, neni 77 dhe 78, Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 102 e vijues;

U R D H Ë R O J

1. Angazhimin e stafit akademik dhe administrativ të UGJ-së në Bordin Organizativ të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, që do të organizohet në bashkëpunim nga Universiteti Karamanoglu Mehmetbey, Turqi dhe Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si vijon:

Prof. dr. Jaho Cana	-	President Nderi
Dr. Arjan Gjini	-	Drejtues i Komitetit Rregullator
Prof. dr. Gëzim Sala	-	Anëtar i Bordit Organizativ
Prof. asoc. Merita Isaraj	-	Anëtare e Bordit Organizativ
Prof. asoc. Valbona Duri	-	Anëtare e Bordit Organizativ
Prof. asoc. Sadik Malo	-	Anëtar i Bordit Organizativ

Prof. asoc. Lorenc Koçiu

Anëtar i Bordit Organizativ

MSc. Semi Golemi

Anëtar i Bordit Organizativ

MSc. Irma Gjollëshi

Sekretare

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jaho Cana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 78 prot.

Gjirokastër, më 14.01 . 2025

U R D H Ë R

Nr. 07 , datë, 14.01 . 2025

P Ë R

PASQYRIMIN E PERIUdhës SË KONSULTIMEVE NË REGJISTRIN E PEDAGOGUT

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë", Rregullores së brendshme të universitetit, neni 53 pika 3 dhe neni 64 pika 3, shkresës nr. 36, datë 13.01.2025 , dhe pas diskutimeve në mbledhjen e Rektoratit të datës 17.01.2025 ;

URDHËROJ ;

1. Pasqyrimin e periudhës 2 javore për sezonin e konsultimeve, në një faqe të veçantë pas përfundimit të programit lëndor, në regjistrin e pedagogut sipas lëndëve përkatëse.
2. Ky urdhër i përcillet zëvendësRektorit për procesin mësimor , drejtuesve të njësive kryesore, drejtuesve të njësive bazë, Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave të cilët ngarkohen për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 98 Prot.

Gjirokastrë, më 21 / 01 /2025

U R D H Ë R

Nr. 08, datë 21 . 01 .2025

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT SHKENCOR PËR
KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE QË UNIVERSITETI "EQREM
ÇABEJ" GJIROKASTËRDO TË ORGANIZOJË NË BASHKËPUNIM ME
UNIVERSITETIN KARAMANOGLU MEHMETBEY, TURQI**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma a, e pika 4, gërma c, neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Kreu IV, neni 30, Kreu IX, neni 77 dhe 78, Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 102 e vijues;

U R D H Ë R O J

1. Angazhimin e stafit akademik të UGJ-së në Bordin Shkencor të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, që do të organizohet në bashkëpunim nga Universiteti Karamanoglu Mehmetbey, Turqi dhe Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si vijon:

- Prof. dr. Valentina Duka
- Prof. dr. Ermal Baze
- Prof. dr. Lavdi Hasani
- Prof. dr. Shyqyri Hysi
- Prof.asoc. Albina Sinani
- Prof.asoc. Spiridhulla Poçi
- Prof.asoc. Merita Shehu
- Prof. asoc. Dr. Kastriot Zoto
- Prof. asoc. Irena Boboli
- Dr. Mariglen Sherifi
- Prof. asoc. Mimoza Zekaj
- Prof. asoc. Mimoza Çarka

- Dr. Kostando Ksera
- Prof. asoc. Kozeta Sala
- Prof. asoc. Joana Taçi
- Doc. Dr. Etleva Peta
- Dr. Arjola Mitaj
- Dr. Antuela Sinani
- Prof. asoc. Dr. Maria Agolli
- Prof. asoc. Dr. Selfo Oruçi

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr. Jaho Cans



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 102 Prot.

Gjirokastrë, më 22.01.2025

URDHËR

Nr. 09, datë 22.01.2025

**PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KOMISIONIN AD HOC PËR SHQYRTIMIN DHE
VLERËSIMIN E KANDIDATURAVE PËR POZICIONIN "SPECIALIST PËR MËSIMIN DHE
KURIKULAT"**

Në mbështetje të, Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 66 pika 3 "Punësimi i personelit akademik", neni 57, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" "Punësimi personelit ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ" neni 8 të Rregullores "Për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej"

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit ad hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin "Specialist për mësimin dhe kurrikulat", pranë Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, si mëposhtë:

- | | |
|--|-----------|
| - Zv. Rektor për procesin mësimor Prof. dr. Gëzim Sala | (Kryetar) |
| - Merita Isaraj | (Anëtare) |
| - Klaviona Dudumu | (Anëtare) |
| - Enkeleda Hoxha | (Anëtare) |
| - Pandeli Kosta | (Anëtare) |

2. Ky komision do të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidaturat sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. dr. Jaho Cana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 106 Prot.

Gjirokastër, më 22.01.2025

URDHËR

Nr. 10, datë 22.01.2025

PËR PËRZGJEDHJEN E STAFIT QË DO TË PËRFSHIHET NË MOBILITETE NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër neni 30, Marrëveshjes Ndërinstitucionale, të nënshkruar nga autoritetet e IES Ribeira do Louro, Spanjë dhe Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, "Thirrjes për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me institucionin arsimor Mestre Mateo Art & Design School, Spanjë", Nr. 1957 Prot., dt 18.12.2024,

URDHËROJ:

1. Përfaqësimin e UGJ-së në aktivitetet e organizuara nga Mestre Mateo Art & Design School, nga stafi akademik dhe administrativ si vijon:

- Prof. Dr. Gëzim Sala
- Z. Semi Golemi

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jaho **CANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 128 Prot.

Gjirokastrë, më 23 / 01 / 2025

URDHËR

Nr. 11, datë 23.01.2025

PËR

PËRFUNDIM TË KONTRATËS SË PUNËS

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 pika 3, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si dhe neni 30 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1. Znj. **Albana Bala**, deri më tani "Specialiste Klasifikatore" në Sektorin e Shërbimeve Bibliotekare-arkivore Studentore, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike –Administrative, meqënëse i përfundoi kontrata e punës i ndërpriten efektet fianciare më datë 24.01.2025.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike -Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 129 Prot.

Gjirokastrë, më 23.01./2025

URDHËR

Nr. 12, datë 23.01.2025

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KANDIDATURAVE PËR POZICIONIN PERSONEL NDIHMËS AKADEMIK ME
KARAKTER ADMINISTRATIV "DREJTOR" PRANË DREJTORISË SË
SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE-ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, pika 5, neni 66, pika 4 "Punësimi i ndihmës akademik", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 54, Rregullores për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, si dhe shpalljes në Buletin e Prokurimeve Publike me nr. 03, datë 20.01.2025,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit ad hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akadematike - Administrative si më poshtë:
 - Prof. Asoc Merita Isaraj **Kryetare**
 - Marianthi Xha **Anëtare**
 - Borana Lelaj **Anëtare**
 - Irma Gjollëshi **Anëtare**
 - Valentina Shehu **Anëtare**
2. Ky komision do të jetë përgjegjës të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidaturat sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, antarët e komisionit të përmendur në pikën 1.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. dr. Jahor CENA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 155 Prot.

Gjirokastrë, më 29/01/2025

URDHËR

Nr. 13, datë 29.01.2025

PËR

**EMËRIMIN E SPECIALISTIT PËR MËSIMIN DHE KURRIKULAT ME KOHËZGJATJE
TË PACAKTUAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 pika 3, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", neni 30 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", si dhe procesverbaline datës me nr.150 prot, datë 28.01.2025,

URDHËROJ:

1. Znj. Alketa Rami, emërohet "Specialiste për Mësimin dhe Kurrikulat" në Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike -Administrative.
 2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë me kohëzgjatje të pacakruar. Kategoria e pagës IV-2 .
 3. Efektet financiare dhe ushtrimi i kompetencave administrative fillojnë më datë 03.02.2025.
 4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike -Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 156 Prot.

Gjirokastrë, më 29.01.2025

URDHËR

Nr. 14, datë 29.01.2025

PËR

**EMËRIMIN E PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME DHE KOHËZGJATJE TË
CAKTUAR NË NJESINË BAZË TË SHKENCAVE BIOLOGJIKE MJEDISOR DHE USHQIMIT**

Në Mbështetje të Ligjit Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VI, "Personeli i institucioneve të arsimit të lartë, "Nenet 57 "Kategorite e personelit akademik " neni 59, pika 8, në nenin 52 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Rregullores për punësimin dhe përzgjedhjen stafit akademik, si dhe mbi bazën e vlerësimeve të pasqyruara në procesverbalin e Komisionit ad-hoc të mbledhur më datë 28.01.2025 për pranimin e personelit akademik në fushën e Biologjisë me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar në Njesinë Bazë të Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës për vitin akademik 2024 – 2025, urdhëroj të miratohet kandidatura si më poshtë:

I. Msc. Klodiana Gjika

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 163 prot.

Gjirokastrë, më 30.01 . 2025

U R D H Ë R

Nr. 15 , datë, 30.01 .2025

P Ë R

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS KONTROLLIN E DOKUMENTACIONIT NË
PËRFUNDIM TË PROCESIT MËSIMOR TË SEMESTRIT TË PARË DHE MONITORIMI I
PROVIMEVE PËR SEZONIN E DIMRIT PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë ", neni 87 "*Viti Akademik dhe organizimi i mësimdhënies*, Statutit të UGJ-së, neni 23, pika 5; neni 30, pika 1/u; Rregullores së brendshme neni 26, pika 2/a dhe pika 3;

URDHËROJ ;

1. Me qëllim përmbylljen e gjithë dokumentacionit për veprimtarinë akademike në përfundim të semestrit të parë, për vitin akademik 2024-2025 dhe mbarëvajtjen e sezonit të provimeve të dimrit do të ngritet grupi i punës institucional, me përbërjen si mëposhtë:

Prof.Dr Gëzim Sala	Zëvendës Rektor për procesin mësimor	Kryetar
Prof.asoc Albina Sinani	Zëvendës Dekan i FESHSH-së	Anëtar
Dr. Robert Çelo	Zëvendës Dekan i FE-së	Anëtar
Dr. Isidor Kokalari	Zëvendës Dekan i FSHN-së	Anëtar
Klavora Dudumi	Përgjegjëse e SSCK-së	Anëtar
Enkeleda Hoxha	Specialist i standarteve të cilësisë dhe vlerësimit institucional	Anëtar

2. Grupi i punës do të ushtrojë detyrën e sipërcituar gjatë gjithë sezonit të provimeve pranë Njësive Kryesore, Njësive Bazë dhe sekretaritë mësimore dhe në përfundim do t'i paraqesi Rektorit të UGJ-së një raport vlerësimi për pikat e forta, të dobta dhe rekomandime për çdo problematikë të dal..
3. Ky urdhër i përcillet zëvendësRektorit për procesin mësimor , drejtuesve të njësive kryesore , drejtuesve të njësive bazë, Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave të cilët ngarkohen për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr Jaho GANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 164 Prot.

Gjirokastër, më 30.01 /2025

URDHËR

Nr. 16, datë 30.01 .2025

PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS NË KUADËR TË KOORDINIMIT TË PROCESIT PËR
SONDAZHIN KOMBËTAR TË STUDENTËVE

Në mbështetje të: Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 104, pika 5, Vendimit nr. 229, datë 14.12.2024 të Bordit të Akreditimit dhe Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, si dhe referuar shkresës së ASCAL, nr. 53 prot, date 23.01.2025, pika 1, në kuadër të organizimit të gjithë procesit për zhvillimin e aktiviteteve për Sondazhin Kombëtar të Studentëve;

URDHËROJ;

1. Ngritjen e grupit të punës në rang institucional për organizimin dhe koordinimin e procesit për Sondazhin Kombëtar të Studentëve me përbërjen si mëposhtë:
Prof.dr Gëzim Sala Zv/REKTOR për procesin mësimor Kryetar
Klavora Dudumi Koordinator Institucional
Ornela Mera Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Student
Prof.asoc Albina Sinani Zëvendës Dekan FESHSH
Dr. Robert Çelo Zëvendës Dekan FE
Dr. Isidor Kokalari Zëvendës Dekan FSHN
Alban Killapi Specialist i rrjetit informatik
Dritan Miho Specialist IT
Enkeleda Hoxha Specialiste e Standarteve të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
2. Ky grup pune do të koordinojë gjithë procesin brenda IAL-së në bashkëpunim me ASCAL-in.
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhëri: Zv/Rektorët, Dekanët e njësive kryesore , Koordinatori Insitucional, Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave, Sektori i Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jano ÇASHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 174 Prot.

Gjirokastrë më, 31.01.2025

URDHËR

Nr. 17, datë 31, 01, 2025

PËR

LIRIM NGA DETYRA PËR SHKAK TË MBUSHJES SË MOSHËS SË PENSIONIT

Mbështetur në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Vendim nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1. Lirimi nga detyra Zj. Violeta Serjani, deri më tani Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Ndihmësakademike- administartive, për shkak të përmbushjes së kushteve të ligjit për pension. Lirimi do të bëhet më datë 31.01.2025.
2. Zj. Violeta Serjani do të përfitojë të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me lirim nga detyra dhe pensionin, siç përcaktohet nga ligji dhe rregulloret përkatëse, përfshirë pagesat dhe përfitimet që lidhen me pensionin.
3. Të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme për dorëzimin e materialeve, si pajisjet, dokumentacionet dhe çdo material tjetër që ndodhet në administrim të tij. Ky proces duhet të kryhet në përputhje me procedurat e brendshme të institucionit.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtorja e Shërbimeve Ndihmësakademike - Administrative si dhe Drejtorja e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Jaho ÇANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 177 Prot.

Gjirokastrë, më 03.02.2025

URDHËR

Nr. 18, datë 03.02.2025

PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT PËR DORËZIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE
MATERIALEVE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" i ndryshuar, Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë", Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit për dorëzimin e dokumentacionit dhe materialeve në përputhje me kërkesat ligjore, për të siguruar një kalim të organizuar dhe të rregullt të detyrës, si më poshtë:

- Marianthi Xha	Kryetare
- Borana Lelaj	Anëtare
- Lidra Miço	Anëtare
- Dritan Miho	Anëtare
- Alban Kllapi	Anëtare
- Martin Zeko	Anëtare
- Valentina Shehu	Anëtare
2. Ky komision do të ketë përgjegjësinë të sigurojë kalimin pa probleme të materialeve dhe dokumenteve të menaxhuara, duke përfshirë çdo pajisje dhe informacion të ngarkuar gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës.
3. Komisioni i përbëhet nga përfaqësuesit e mësipërm, të cilët do të kenë përgjegjësi për të kryer e verifikimet dhe dorëzimet e materialeve.
4. Komisioni do të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme për të siguruar që dokumentet dhe materialet të dorëzohen dhe të kalojnë në dorëzim në mënyrë të plotë dhe të saktë:

Verifikimi i Materialeve dhe Dokumenteve

- Drejtori do të përgatisë një listë të plotë të materialeve dhe pajisjeve që ka në ngarkim, duke përfshirë:
 - a) Dosjet e punonjësve dhe dokumentet e menaxhuara nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative;
 - b) Raportet dhe regjistrat e ndryshëm;
 - c) Pajisjet elektronike dhe kompjuterike;
 - d) Materialet që janë arkivuar dhe që duhet të ruhen për periudha të gjata;
 - e) Çdo material tjetër të lidhur me aktivitetet e Drejtorisë;
- Komisioni do të realizojë verifikimin e plotë të të gjitha materialeve dhe dokumenteve që Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative ka pasur në ngarkim gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

Regjistrimi dhe Verifikimi i Gjendjes së Materialeve

- Të gjitha materialet dhe dokumentet do të regjistrohen dhe do të verifikohen për gjendjen e tyre aktuale (p.sh., dëmtime, humbje, etj.)
- Nëse ndodhin disfunksionalitete apo dëmtime të pajisjeve elektronike, komisioni do të përpilojë një raport dhe do të japë rekomandimet për trajtimin e mëtejshëm.

Dorëzimi i Materialeve dhe Pajisjeve

- Komisioni do të sigurojë që materialet dhe pajisjet të dorëzohen në gjendje të plotë dhe të ruajtshme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregulloret e institucionit. Çdo material që nuk është më i nevojshëm për përdorim të drejtpërdrejtë do të kalojë për arkivim në mënyrë të sigurt dhe të përhershme.

Hartimi i Procesverbalit të Dorëzimit

- Pas përfundimit të verifikimit dhe pranimit të materialeve, komisioni do të hartojë një procesverbal dorëzimi, i cili do të përmbajë:
 - Detajet e materialeve dhe pajisjeve të dorëzuara;
 - Gjendjen e materialeve (përfshirë çdo dëmtim ose humbje);
 - Datat e dorëzimit dhe periudhat kohore të realizimit të procesit të dorëzimit;
 - Nënshkrimet e anëtarëve të komisionit dhe Drejtorit i Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative.

- Ky procesverbal do të jetë dokumenti përfundimtar dhe do të ruhet në arkivat e institucionit.

Përgatitja dhe përkrahja e dorëzimit

- Komisioni është i autorizuar të ofrojë ndihmën e nevojshme gjatë procesit të dorëzimit të materialeve, duke përfshirë:
 - Sigurimin e një periudhe kohore të përshtatshme për dorëzimin e materialeve;
 - Ndihmën për paketimin dhe ruajtjen e materialeve të arkivuara në kushte të sigurta dhe të përshtatshme;
 - Ofertimin e udhëzimeve dhe mbikëqyrjen gjatë kalimit të pajisjeve elektronike dhe materialeve të tjera.
5. Ky urdhër hyn në fuqi nga data e lëshimit dhe është i detyrueshëm për të gjitha palët e përfshira, përfshirë Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative, anëtarët e komisionit dhe departamentet e tjera të institucionit që mund të jenë të përfshira në këtë proces. Komisioni do të sigurojë që procesi të përfundojë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri dhe të raportohet për çdo çështje që mund të dalë gjatë verifikimit dhe dorëzimit të materialeve.
 6. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri komisioni i posaçëm, punonjësi dorëzues si dhe punonjësi që merr në dorëzim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
R E K T O R I

Nr. 181 Prot.

Gjirokastrë më, 03.02.2025

U R D H Ë R

Nr. 19, datë 03, 02, 2025

P Ë R

EMËRIM NË DETYRË

Mbështetur në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, neni 57, neni 66, Vendim nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 42, neni 54, Rregullore nr. 26, datë 08.09.2020 "Për punësimin e stafit akademik dhe atij administrativ pranë Ugj-së", Njoftimit nr. 145, datë 27.01.2025;

URDHËROJ :

1. Emërimin e **Zj. Matilda Feruni**, si kandidaturë e cila ka përmbushur të gjitha kriteret dhe kushtet ligjore, në pozicionin Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative duke filluar nga data **04.02.2025**.
2. Zj. Matilda Feruni ka detyrën dhe përgjegjësinë për të kryer të gjitha detyrat dhe funksionet e përcaktuara në përshkrimin e punës për këtë pozicion, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të pozicionit.
 - Çdo detyrë tjetër të caktuar nga titullari i institucionit.
3. Përshtatjen e emërtesës me nivelin e pagës, sipas kategorisë së vendit të punës.
4. Ky urdhër është i detyrueshëm për të gjithë personelin dhe departamentet përkatëse të institucionit për të siguruar zbatimin e duhur të procedurave dhe kalimin e përgjegjësive, në përputhje me rregulloret dhe politikat e institucionit.

5. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike - Administrative si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr Jaho ÇABA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 190/1 prot.

Gjirokastrë, më 05.02 . 2025

URDHËR

Nr. 20 , datë 05.02.2025

" PËR DHËNIE LEJE PA TË DREJTË PAGE"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së z. Bledar Late me nr. 190 prot, datë 05.02.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet leje pa të drejtë page z. **Bledar Late** personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njësinë Bazë të Infermierisë, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **10 – 14. 02. 2025**
- 3 .Paraqitja në punë **17.02.2025**
- 4.Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTOR

Prof.Dr. **Jaho ÇANA**



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 194 Prot.

Gjirokastrë, më 05.1.02.2025

URDHËR

Nr. 21, datë 05.02.2025

**PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KOMISIONIN AD HOC PËR SHQYRTIMIN DHE
VLERËSIMIN E KANDIDATURAVE PËR POZICIONIN "SPECIALIST KLASIFIKATOR"**

Në mbështetje të, Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 66 pika 3 "Punësimi i personelit akademik", neni 57, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" "Punësimi personelit ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ" ninit 8 të Rregullores "Për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej"

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit ad hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin "Specialist Klasifikator" pranë Sektorit të Shërbimeve Bibliotekare-Arkivore Studentore pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative, si mëposhtë:

- | | |
|--|-----------|
| - Zv. Rektor për procesin mësimor Prof. dr. Gëzim Sala | (Kryetar) |
| - Ornela Mera | (Anëtare) |
| - Klaviona Dudumi | (Anëtare) |
| - Eliona Frengu | (Anëtare) |
| - Pandeli Kosta | (Anëtare) |

2. Ky komision do të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidaturat sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. dr. Jaho Cana



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 199/1 prot.

Gjirokastrë, më 05.02 . 2025

URDHËR

Nr. 22 , datë 05.02.2025

" PËR DHËNIE LEJE PA TË DREJTË PAGE"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së znj. Marjeta Fule me nr. 199 prot, datë 05.02.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, **znj. Marjeta Fule** në pozicionin Specialiste për Menaxhimin e Veprimtarisë Kërkimore Shkencore pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike - Administrative.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **06.02.2025**
- 3 .Paraqitja në punë **07.02.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 201 Prot.

Gjirokastrë, më 06.02.2025

URDHËR

Nr. 23, datë 06.02.2025

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR PROJEKT RREGULLOREN NË MOBILITETE

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 30,

URDHËROJ:

- Ngritjen e Komisionit *ad hoc* për projekt rregulloren për mobilitetet, me këtë përbërje:
 1. Kryetar, Prof. Dr. Gzim Sala, si përfaqësues i Rektoratit.
 2. Anëtare, Prof. Asoc. Merita Shehu, si përfaqësuese e Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqrore.
 3. Anëtare, Prof. Asoc. Maria Agolli, si përfaqësuese e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.
 4. Prof. Asoc. Irena Boboli, si përfaqësuese e Fakultetit Ekonomik.
 5. Marianthi Xha, si përfaqësuese e Administratës.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, anëtarët e komisionit të lartë përmendur.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 202 Prot.

Gjirokastrë më, 06.02.2025

URDHËR

Nr. 24, datë 06, 02, 2025

PËR

**FILLIMIN E PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËN E ZHVILLIMIT TË
ZGJEDHJEVE PËR ANËTAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT, PËRFAQËSUES I
MAS**

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 48, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 30 pika 2, Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve, për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë", neni 5 e vijues, shkresës nr. 7507/2, datë 15.01.2025 të MAS, si dhe duke marrë parasysh nevojën për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme me dorëheqjen e njërit prej anëtarve të Bordit të Administrimit,

URDHËROJ :

1. Fillimin e procesit zgjedhor për anëtar të Bordit të Administrimit, përfaqësues i MAS në datën 10.02.2025.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve sipas pikës 1 të këtij Urdhëri, do të jetë data 13.03.2025.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Administratori dhe Komisioni Institucional i Zgjedhjeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

REKTORI

Nr. 234 Prot.

Gjirokastrë, më 12 / 02 / 2025

URDHËR

Nr. 25, datë 12.02.2025

PËR

**EMËRIMIN SPECIALIST KLASIFIKATOR ME KOHË TË PLOTË DHE
KOHËZGJATJE TË PACAKTUAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 pika 3, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", neni 30 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", në procesverbalin e komisionit ad-hoc të datës 06.02.2025,

URDHËROJ:

1. **Znj. Albana Bala**, emërohet "Specialiste Klasifikatore" në Sektorin e Shërbimeve Bibliotekare-Arkivore Studentore, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike -Administrative.
 2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë me kohëzgjatje të pacakruar.
 3. Kategoria e pagës IV-2 .
 4. Efektet financiare dhe ushtrimi i kompetencave administrative fillojnë më datë 17.02.2025.
 5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike -Administrative, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA

Adresa: Lagja "18 Shtatori", Rr. "Studenti", Gjirokastrë
Kodi postar: 6001, web: www.uogj.edu.al



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI**

Nr. 244 Prot

Gjirokastër më, 13.02.2025

URDHËR

Nr. 26, datë 13.02.2025

PËR

ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMISIONIT TË EKSPERTIZËS

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 " Për Arkivat " neni 7, i " Normave tekniko - profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë " neneve 32, 33, 34, 35, Vendimit Nr. 4 datë 19.06.2017 "Për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" neni 5 si dhe Urdhërit nr. 17 datë 31.01.2025 dhe Urdhërit 19, datë 03.02.2025

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e anëtarit të Komisionit të Ekspertizës, znj. Violeta Serjani me znj. Matilda Feruni e emëruar Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative me urdhër nr. 19, datë 03.02.2025.
2. Ngarkohen për njohje anëtarët e tjerë të komisionit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 268 Prot.

Gjirokastrë më, 17.02.2025

URDHËR

Nr. 27, datë 17.02, 2025

PËR

PËRSHTATJEN E EMËRTIMIT TË POZICIONIT TË PUNËS

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 39 pika 5, neni 57, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" pika 1, gërma k, Vendimit nr 10, datë 06.02.2025 "Për miratimin e strukturës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë,

URDHËROJ :

1. Ndryshimin e emërtesës së pozicionit të punës për Z. Alban Kllapi i cili aktualisht mban titullin "Specialist i rrjetit informatik" pranë Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave në pozicionin e ri "Përgjegjës i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Promovimit dhe Inovacionit" pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënive me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
2. Përshtatjen e emërtesës me nivelin e pagës, sipas kategorisë së vendit të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERISITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 269 Prot.

Gjirokastrë më, 17.02.2025

URDHËR

Nr. 28, datë 17, 02, 2025

PËR

PËRSHTATJEN E EMËRTIMIT TË POZICIONIT TË PUNËS

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 39 pika 5, neni 57, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" pika 1, gërma k, Vendimit nr 10, datë 06.02.2025 "Për miratimin e strukturës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e emërtesës së pozicionit të punës për zj. Klaviona Dudumi e cila aktualisht mban titullin "Përgjegjëse në Sektorin e Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave" në titullin e ri "Drejtor" pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënive me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
2. Përshtatjen e emërtesës me nivelin e pagës, sipas kategorisë së vendit të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 270 Prot.

Gjirokastrë më, 17.02.2025

URDHËR

Nr. 29, datë 17, 02, 2025

PËR

EMËRIM NË DETYRË

Mbështetur në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, pika 5, neni 57, neni 66, Vendim nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" neni 42, neni 54, Regullore e Ugj-së, Vendim i Senatit Akadenik nr.10, datë 06.02.2025,

URDHËROJ :

1. Emërimin në detyrën e Përgjegjës i Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënive me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit. **Znj. Violeta Serjani.**
2. Përshtatjen e emërtesës me nivelin e pagës, sipas kategorisë së vendit të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 271 prot.

Gjirokastrë, më 17.02. 2025

U R D H Ë R

Nr. 30, datë, 17.02. 2025

PËR

**HARTIMIN DHE ZHVILLIMIN E LËNDËS "MATEMATIKË FINACIARE" DHE
"MATEMATIKË NË SHKENCAT E APLIKUARA" NGA PERSONEL AKADEMIK NË
MBËSHTETJE TË KRITEREVE PSIKO-PEDAGOGJIKE SIPAS FUSHËS SË STUDIMEVE**

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 679 Prot.

Gjirokastrë, më 16.04/2025

URDHËR

Nr. 63, datë 16.04.2025

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STUDENTËVE DHE STAFIT TË PËRFSHIRË NË
MOBILITETE NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 e neni 93. Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 30, komunikimit me postë elektronike zyrtare midis Universitetit të Gjirokastrës dhe Universitetit Goluchowski të Shkencave të Aplikuara, Poloni, "Thirrjes për pjesëmarrje në programin Erasmus+ me Universitetin Goluchowski, Poloni" Nr. 561 Prot., datë 03/04/2025, për realizimin e mobiliteteve midis dy institucioneve,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit ad hoc për vlerësimin e dokumentacionit të studentëve dhe stafit akademik/administrativ që do të përfshihen në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, me këtë përbërje:

Prof. asoc. Merita Isaraj	Kryetare
Prof. asoc. Sadik Malo	Anëtar
Irma Gjollëshi	Anëtare
2. Ky komision do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga stafi akademik dhe administrativ i interesuar për mobilitet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, anëtarët e komisionit të përmendur në pikën 1.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jahid CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 686/1 prot.

Gjirokastrë, më 17.04 . 2025

URDHËR

Nr. 64 , datë 17.04.2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së z.Romeo Mano me nr. 686 prot, datë 17.04.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, **z.Romeo Mano** në pozicionin Pedagog pranë Departamentit të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Fakulteti të Shkencave të Natyrës.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **05.05.2025**
- 3 .Paraqitja në punë **06.05.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA

*Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokastrë 6001, Tel: 084263408 ,
web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr 696 Prot.

Gjirokastrë më, 22.04.2025

URDHËR

Nr. 65, datë 22, 04, 2025

PËR

**RIVLERËSIMIN E DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR DOKTORATURË SI PASOJË
E AMENDIMEVE NË RREGULLOREN E DOKTORATURËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të akteve nënligjore përkatëse, si dhe në zbatim të ndryshimeve të miratuara në Rregulloren e Studimeve të Doktoraturës, të hyrë në fuqi me Vendimin e Senatit Akademik nr.22, datë 15.04.2024, si dhe për të garantuar përputhshmërinë e procedurave me kuadrin e ri rregullator,

URDHËROJ:

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore që ofron këtë program doktore të marr masat e nevojshme për rivlerësimin e dosjeve të kandidatëve për doktoraturë, të cilët janë në proces aplikimi, përzgjedhjeje ose janë pranuar sipas rregullores së mëparshme, por që nuk e kanë përfunduar ende procesin.
2. Rivlerësimi të kryhet në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren e re të Doktoraturës, duke vlerësuar përputhshmërinë e dokumentacionit dhe nevojën për plotësim apo përditësim të tij.
3. Dekania e fakultetit përkatës të garantoj zbatimin e këtij procesi në mënyrë të njëtrajtshme, transparente dhe në afatet e përcaktuara në rregullore.
4. Afati për përfundimin e rivlerësimit të të gjitha dosjeve është data 30.04.2025.
5. Fakulteti të raportojnë në Rektorat mbi ecurinë dhe rezultatet e këtij procesi brenda 5 ditëve pas përfundimit të afatit të sipërcituar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr Jaho ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI**

Nr. 719 Prot.

Gjirokastrë, më 24.04/2025

URDHËR

Nr. 66, datë 24.04.2025

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STAFIT TË PËRFSHIRË NË MOBILITETE NË
KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 e neni 93. Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 30, komunikimit me postë elektronike zyrtare midis Universitetit të Gjirokastrës dhe Universitetit Goluchowski të Shkencave të Aplikuara, Poloni, "Thirrjes për pjesëmarrje në programin Erasmus+ me Universitetin Goluchowski, Poloni" Nr. 694 Prot., datë 18/04/2025, për realizimin e mobiliteteve midis dy institucioneve,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit ad hoc për vlerësimin e dokumentacionit të stafit akademik që do të përfshihen në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+, me këtë përbërje:

Prof. asoc. Merita Isaraj	Kryetare
Prof. asoc. Sadik Malo	Anëtar
Irma Gjollëshi	Anëtare

2. Ky komision do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga stafi akademik i interesuar për mobilitet.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, anëtarët e komisionit të përmendur në pikën 1.

Ky Urdhër hyj në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jahor ~~ÇANA~~



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 721/1 prot.

Gjirokastrë, më 24.04 . 2025

URDHËR

Nr. 67 , datë 24.04.2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së znj. Edlira Isaraj me nr. 721 prot, datë 24.04.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025 **znj. Edlira Isaraj** personel ndihmës akademik me karakter mësimor, laborante pranë Fakultetit Ekonomik
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **25 - 30.04.2025.**
- 3 .Paraqitja në punë **02. 05. 2025.**
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. **Jahir ÇABAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. ⁷²⁹~~729~~ prot.

Gjirokastrë, më ^{28.04}~~28.04~~.2025

URDHËR

Nr. ⁶⁸~~68~~, datë ^{28.04}~~28.04~~.2025

PËR TË PUNUAR JASHTË KOHËS NORMALE TË PUNËS

Në zbatim të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjet: nr. 8085, datë 13.3.1996; nr.9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015; nr. 91/2024, datë 26.7.2024 neni 89 "Detyrimi për të kryer orë shtesë", në V.K.M. Nr.568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetqeverisjes vendore" pika 10, urdhërit nr. 525 prot. datë 26.03.2025 "Për aktivizimin e strukturave në mbështetje të zbatimit të Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2024-2025"

URDHËROJ :

Të punojë jashtë kohës normale të punës punonjësi i mëposhtëm:

Nr.	Emër Mbiemër	Data	Orë gjithsej
1	Alban Kllapi	29.04.2025 x 2.5	2.5 orë
		30.04.2025 x 2.5	2.5 orë

REKTORI

Prof. Dr. Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 730/ prot.

Gjirokastrë, më 28.04 . 2025

URDHËR

Nr. 69 , datë 28.04.2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR ”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së z. Roland Vasili me nr. 730 prot, datë 28.04.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025 z. **Roland Vasili** personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njësinë Bazë të Matematikës, Informatikës Dhe Fizikës, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **29. 04.2025.**
- 3 .Paraqitja në punë **30. 04. 2025.**
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jefo ÇASLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 755 Prot.

Gjirokastrë më, 30.04.2025

URDHËR

Nr. 70, datë 30, 04, 2025

PËR

**CAKTIMIN E DITËS SË PREMTE, DATË 02.05.2025 SI DITË PUSHIMI, DHE
ZËVENDËSIMIN E SAJ ME DATËN 17 MAJ 2025 (E SHTUNË)**

Në zbatim të nenit 18/4, pika 2, gërma c e neni 78 të ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë (Ndryshuar me ligjet: nr. 8085, datë 13.3.1996; nr.9125, datë 29.7.2003; nr. 10 053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015; nr. 91/2024, datë 26.7.2024), neni 39 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë. si dhe në zbatim të kompetencave të drejtuesit të institucionit për organizimin dhe menaxhimin e brendshëm të institucionit:

URDHËROJ:

1. Dita e premte, datë 02.05.2025, shpallet ditë pushimi për të gjithë punonjësit e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Kjo ditë pushimi do të zëvendësohet me datën 17 maj 2025 (e shtunë), e cila do të jetë ditë pune për të gjithë punonjësit.
3. Njësitë Kryesore të UGJ-së, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të marrë masat përkatëse për zbatimin e këtij urdhri dhe njoftimin e punonjësve.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet të gjithë strukturave për zbatim.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 764 / prot.

Gjirokastrë, më 05.05 . 2025

URDHËR

Nr. 71 , datë 05.05.2025

" PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR "

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së znj.Antuela Sinani me nr.764 prot, datë 05.05.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes vjetore për vitin 2025, **znj.Antuela Sinani** në pozicionin Përgjegjëse e Njesisë Bazë të Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **13– 19. 05.2025**
- 3 .Paraqitja në punë **20.05.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 72/ prot.

Gjirokastër, më 06.05. 2025

URDHËR

Nr. 72, datë 06.05.2025

" PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së znj.Brikena Metaj me Nr.772 Prot, datë 06.05.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes vjetore për vitin 2025, **znj.Brikena Metaj** në pozicionin Specialiste e Promovimit Institucional dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Promovimit dhe Inovacionit, pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **12.05.2025 - 17.05.2025**
- 3 .Paraqitja në punë **19.05.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokaster 6001, Tel: 084263408 ,
web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI**

Nr. 792 Prot

Gjirokastrë, më 12.05. 2025

URDHËR

Nr. 73, datë 12.05 2025

**PËR
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ" PËR
KRIJIMIN E QENDRËS SË KËRKIMIT PËR ZHVILLIM VENDOR NË PARTNERITET
ME ORGANIZATËN PËR BASHKËPUNIM DHE SIGURI NË EUROPE, OSCE.**

Në mbështetje të nenit 39, pika 12 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 30 pika 1/a të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej"; të nenit 21 të Rregullores së Universitetit,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit të punës, i cili ka për qëllim realizimin e një studimi fizibiliteti me grupin e punës së OSCE. Grupi i punës përbëhet nga dy pjestarë të stafit akademik për çdo njësi kryesore, nën drejtimin e koordinatorit, konkretisht:
 - a. Përfaqësues të Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqerore;
Prof. Asoc. Albina Sinani, Dr. Mariglen Sherifi
 - b. Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave të Natyrës;
Prof. Dr. Lavdi Hasani, Msc. Zhenisa Çuni
 - c. Përfaqësues të Fakultetit Ekonomik;
Prof. Asoc. Lorenc Koçiu, Dr. Zamira Veizi
 - e. Koordinator;
Dr. Arjan Gjini
2. Ky urdhër ju komunikohet njësisë bazë dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Jaho ÇABA

Lagjia "18 Shtatori", Rruga Studenti, Gjirokastrë
Kodi Postar 6001, web:www.uogj.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 797 Prot.

Gjirokastrë më, 14.05.2025

URDHËR

Nr. 74, datë 14, 05, 2025

PËR

HEQJEN E PEZULLIMIT NGA DETYRA

Mbështetur në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 3, pika 8, nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Vendim nr. 9, datë 24.12.2020 "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve". Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej", Regulloren e Ugj-së, si dhe në zbatim të përfundimit të periudhës së pezullimit të përcaktuar në urdhrin nr. 59, datë 02.04.2025, për pezullimin nga detyra të Prof. Dr. Shyqyri Hysi gjatë fushatës zgjedhore,

URDHËROJ:

1. Nga data 14.05.2025, hiqet pezullimi nga detyra për Prof. Dr. Shyqyri Hysi, anëtar i stafit akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, dhe ky i fundit rikthehet në detyrë në përputhje me statusin e tij akademik dhe kontratën përkatëse të punës.
2. Rikthimi në detyrë bëhet me të njëjtat kushte dhe të drejta që gëzonte para pezullimit, pa asnjë ndryshim në pozicionin e punës apo statusin e tij në institucion.
3. Njësia bazë të marr masat për të zëvendësuar të gjitha orët mësimore të humbura gjatë periudhës së pezullimit, duke respektuar ngarkesën vjetore dhe standardet akademike të programit mësimor.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri: Administratori i Universitetit, Drejtorja Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Fakultetit i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore si dhe strukturat përkatëse akademike dhe administrative.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
R E K T O R I

Nr 798 Prot.

Gjirokastrë më, 14.05.2025

U R D H Ë R

Nr. 75, datë 14, 05, 2025

P Ë R
HEQJEN E PEZULLIMIT NGA DETYRA

Mbështetur në ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 3, pika 8, nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", Vendim nr. 9, datë 24.12.2020 "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve". Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej", Regulloren e Ugj-së, si dhe në zbatim të përfundimit të periudhës së pezullimit të përcaktuar në urdhrin nr. 58, datë 02.04.2025, për pezullimin nga detyra të zj. Alma Kore gjatë fushatës zgjedhore,

U R D H Ë R O J:

5. Nga data 14.05.2025, hiqet pezullimi nga detyra për zj.Alma Kore, anëtare e stafit akademik të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, dhe kjo e fundit rikthehet në detyrë në përputhje me statusin e saj akademik dhe kontratën përkatëse të punës.
6. Rikthimi në detyrë bëhet me të njëjtat kushte dhe të drejta që gëzonte para pezullimit, pa asnjë ndryshim në pozicionin e punës apo statusin e saj në institucion.
7. Zj. Alma Kore detyrohet të zëvendësojë të gjitha orët mësimore të humbura gjatë periudhës së pezullimit, në koordinim me Drejtuesin e Njësisë Bazë të Fakultetit Ekonomik, duke respektuar ngarkesën vjetore dhe standardet akademike të programit mësimor.

8. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri: Administratori i Universitetit, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Fakultetit Ekonomik si dhe strukturat përkatëse akademike dhe administrative.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 799 Prot.

Gjirokastrë më, 14.05.2025

URDHËR

Nr. 76, datë 14, 05, 2025

PËR
PËRSHTATJEN E EMËRTIMEVE TË POZICIONEVE TË PUNËS ME STRUKTURËN
E RE

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 39 pika 5, neni 57, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" pika 1, gërma k, Vendimit nr 10, datë 06.02.2025 "Për miratimin e strukturës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Vendimi nr. 02, datë 14.02.2025 "Miratim i strukturës akademike administrative dhe numri i personelit për të gjitha nivelet për vitin 2025".

URDHËROJ :

1. Përshtatjen e emërtimeve të pozicioneve të punës në kuadër të strukturës së re organizative, emërimet dhe titujt e pozicioneve të punës do të përshtaten për të pasqyruar natyrën dhe përgjegjësitë e reja të pozicionit për rritjen e efikasitetit të institucionit.
2. Përshtatja e titujve dhe përgjegjësiave do të ndodhë për të gjithë punonjësit që janë të përfshirë në këtë ndryshim. Si pasojë e ndryshimit të strukturës, për disa pozita do të ndryshojnë titujt dhe përgjegjësitë.

Këtu përfshihen:

- Ishte Zv. Rektor për Procesin Mësimor është ndryshuar në Zëvendës Rektor për Çështjet Akademike dhe Zhvillimin Institucional.
- Ishte Zv. Rektor për Shkencën dhe Marrëdhëniet me Jashtë është ndryshuar në Zëvendës Rektor për Kordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor.
- Ishte Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative bëhet Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- Ishte Drejtor i Shërbimeve Ndihmës Akademike-Administrative është ndryshuar në Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

- Ishte Përgjegjës Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personeli dhe Sekretari – Protokoll është ndryshuar në Përgjegjës Sektori pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- Ishte Specialist arkivi është ndryshuar në Specialist i arkivës dhe digjitalizimit të dokumentit zyrtar.
- Ishte Specialist Protokolli në Rektorat është ndryshuar në Specialist Protokolli.
- Ishte Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënie me Jashtë është ndryshuar në Sektori i Kordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.
- Ishte Specialiste në Qendrën Universitare Ndërdisciplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit është ndryshuar në Specialiste e Qendrës Ndërdisciplinore të Kërkimit dhe Zhvillimit.
- Ishte Përgjegjës i Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënie me jashtë është ndryshuar në Përgjegjës Sektori pranë Sektorit të Kordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor.
- Ishte Specialist i Protokollit për Marrëdhëniet me Jashtë është ndryshuar në Specialist për Kordinimin e Marrëdhënieve Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
- Ishte Specialist për Menaxhimin e Veprimtarisë Kërkimore-Shkencore është ndryshuar në Specialist i Kërkimit Shkencor dhe Qendrës së të mësuarit gjatë gjithë jetës (LLL).
- Shtohet Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brëndshëm, Marrëdhënie me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
- Ishte Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave është ndryshuar në Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë.
- Ishte Përgjegjës i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave është ndryshuar në Përgjegjës Sektori pranë Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë.
- Shtohet Specialist për Kurrikulat dhe Procesin Mësimor.
- Ishte Sektori i Shërbimeve Bibliotekare-Arkivore dhe Studentore bëhet Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Bibliotekës Shkencore Institucionale.
- Ishte Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Bibliotekare-Arkivore dhe Studentore është ndryshuar në Përgjegjës i Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Bibliotekës Shkencore Institucionale.
- Ishte Specialist i ALUMNI-it dhe Formimit të Vazhduar është ndryshuar në Specialist i këshillimit të Karrierës dhe ALUMNIT.
- Ishte Specialist Klasifikator është ndryshuar në Specialist Biblioteke.
- Ishte Bibliotekare është ndryshuar në Bibliotekar/Klasifikator.
- Shtohet Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Promovimit dhe Inovacionit.
- Ishte Specialist i Statistikë – Informacionit është ndryshuar në Specialist për Përpunimin e të dhënave Statistike Institucionale.
- Ishte Specialist IT është ndryshuar në Specialist i Inovacionit dhe Menaxhimit të web-it Zyrtar.
- Ishte Specialist i Marrëdhënie me Publikun është ndryshuar në Specialist i Promovimit Institucional dhe Marrëdhënieve me Publikun.

- Shtohet **Teknik i Mesëm për Shërbimet e Rrjetit** (me kontratë me kohë të pjesshme).
3. Përshtatja e strukturës së pagave dhe përfitimeve, ndryshimi i titullit të pozicionit dhe përgjegjësi do të ndikojë në strukturën e pagës dhe përfitimeve vetëm sipas Vendimit nr. 10, datë 06.02.2025 të Senatit Akademik.
 4. Të gjithë punonjësit që preken nga ky ndryshim do të njoftohen personalisht përmes një njoftimi të brendshëm ose takimesh individuale.
 5. Të gjitha dokumentet administrative, përfshirë kontratat e punës, përshkrimet e detyrave, raportet e performancës dhe regjistrat e pagave, do të përditësohen për të pasqyruar titujt dhe përgjegjësitë e reja.
 6. Implementimi do të monitorohet nga Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, e cila do të sigurojë që të gjitha pozitat të jenë në përputhje me strukturën e re organizative.

Ky urdhër do të hyjë në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet për të gjitha pozitat që janë përshtatur me strukturën e re të institucionit.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇABA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 806/ prot.

Gjirokastrë, më 14.05. 2025

URDHËR

Nr. 74, datë 14.05.2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR ”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së zj. Matilda Feruni me nr. 806 prot, datë 14.05.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025 zj. **Matilda Feruni** në pozicionin Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **15.05.2025.**
- 3 .Paraqitja në punë **16. 05. 2025.**
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. **Jahona**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 823/ prot.

Gjirokastrë, më 16 .05 . 2025

URDHËR

Nr. 78 , datë 16 .05 .2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së znj. Jonilda Llupa me nr. 823 prot, datë 16.05.2025

URDHËROJ :

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, **znj. Jonilda Llupa** në pozicionin Specialiste për Projektet në Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **17. 05.2025**
- 3 .Paraqitja në punë **19.05.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho **CANA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 903/ prot.

Gjirokastrë, më 30.05. 2025

U R D H Ë R

Nr. 79, datë 30.05.2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së znj.Klaviora Dudumi me nr. 903 prot, datë 30.05.2025.

U R D H Ë R O J :

1. Ti miratohet dhënia e lejes së vitit 2024 për pjesën e mbetur të pa konsumuar, **znj.Klaviora Dudumi** në pozicionin Drejtore e Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **13.06.2025 - 17.06.2025**.
- 3 .Paraqitja në punë **18.06.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaha CANA

*Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokastrë 6001, Tel: 084263408 ,
web: www.uogj.edu.al ,email : rektori@uogj.edu.al*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 919 prot.

Gjirokastrë, më 02.06. 2025

URDHËR

Nr. 80, datë, 02.06. 2025

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS KONTROLLIN E DOKUMENTACIONIT NË
PËRFUNDIM TË PROCESIT MËSIMOR TË SEMESTRIT TË DYTË DHE MONITORIMI I
PROVIMEVE PËR SEZONIN E VERËS PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Në mbështetje të ligjit 80/ 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 87 "*Viti Akademik dhe organizimi i mësimdhënies*, Statutit të UGJ-së, neni 23, pika 5; neni 30, pika 1/u; Rregullores së brendshme neni 26, pika 2/a dhe pika 3;

URDHËROJ ;

1. Me qëllim përmbylljen e gjithë dokumentacionit për veprimtarinë akademike në përfundim të semestrit të dytë, për vitin akademik 2024-2025 dhe mbarëvajtjen e sezonit të provimeve të verës do të ngritet grupi i punës institucional, me përbërjen si mëposhtë:

a. Prof.Dr Gëzim Sala	Zëvendës Rektor për procesin mësimor	Kryetar
b. Prof.asoc Albina Sinani	Zëvendës Dekan i FESHSH-së	Anëtar
c. Dr. Robert Çelo	Zëvendës Dekan i FE-së	Anëtar
d. Dr. Isidor Kokalari	Zëvendës Dekan i FSHN-së	Anëtar
e. Klaviona Dudumi	Përgjegjëse e DSKMI-së	Anëtar
f. Enkeleda Hoxha	Specialist i standarteve të cilësisë dhe vlerësimit institucional	Anëtar

2. Grupi i punës do të ushtrojë detyrën e sipërcituar gjatë gjithë sezonit të provimeve pranë Njësive Kryesore, Njësive Bazë dhe sekretariatë mësimore dhe në përfundim do t'i paraqesi Rektorit të UGJ-së një raport vlerësimi për pikat e forta, të dobta dhe rekomandime për çdo problematikë të dal.
3. Ky urdhër i përcillet zëvendësRektorit për procesin mësimor , drejtuesve të njësive kryesore , drejtuesve të njësive bazë, Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, të cilët ngarkohen për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr Jahor CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 940 Prot.

Gjirokastrë më, 03.06.2025

URDHËR

Nr. 81, datë 03.06.2025

PËR

LEJIMIN E PËRFUNDIMIT TË VITIT AKADEMIK NGA ZJ. EDUINA GUGA PA TË
DREJTË PAGE

Në mbështetje të Neneve përkatëse të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39; Marrëveshjes së ndërprerjes së marrëdhënies së punës me mirëkuptim me Zj. Eduina GUGA, nr. 822, datë 16.05.2025; Kërkesës së titullarit të njësise akademike përkatëse, për të garantuar përfundimin e procesit mësimor dhe vlerësues në interes të studentëve;

URDHËROJ:

1. Lejohet zj. Eduina GUGA, ish-pedagoge pranë Departamentit të Kontabilitet Financës, të vijojë dhe përfundojë detyrimet e saj akademike të vitit akademik 2024–2025, për lëndët përkatëse, pa të drejtë shpërblimi financiar, duke qenë se marrëdhënia e punës me institucionin është ndërprerë me marrëveshje për shkaqe të justifikuara institucionale.
2. Angazhimi në këtë proces është në funksion të integritetit të procesit mësimor dhe në interes të studentëve, dhe nuk krijon marrëdhënie të re pune.
3. Zbatimin e këtij urdhri e ndjek Dekani i Fakultetit Ekonomik, në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm dhe strukturat përkatëse administrative.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për dijeni Dekanit të Fakulteti Ekonomik, Përgjegjësit të njësise bazë të Kontabilitet Financës, Sekretarisë Mësimore, Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Shërbimeve Universitare.

REKTOR

PROF. DR JAHO ÇANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 957 Prot.

Gjirokastrë, më 05.06.2025

URDHËR

Nr. 82, datë 05.06.2025

PËR

ANULIMIN E URDHËRIT NR.65, DATË 22.04.2025

Në mbështetje të: Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39; Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 113, neni 117 pika 2, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 29, Rregullores institucionale neni 21, Rrethanës faktike se Urdhri nr. 65 datë 22.04.2025, është lëshuar mbi bazën e një rregulloreje ende në fazë draftimi, e pamiratur nga organet kompetente dhe, për rrjedhojë, nuk përbën bazë juridike për nxjerrjen e një akti ekzekutiv;

URDHËROJ:

1. Anulimin e Urdhri nr. 65, datë 22.04.2025, i cili do të konsiderohet akt administrativ i pavlefshëm, në kuptim të nenit 114 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe anulohet në mënyrë të plotë, për faktin se është nxjerrë mbi një dokument (rregullore) të pambaruar dhe të pa miratur, duke cënuar procedurën dhe bazën materiale të vlefshmërisë.
2. Anulimi ka efekt ex tunc (nga momenti i nxjerrjes së aktit), dhe rrjedhimisht, çdo efekt i prodhuar nga ky urdhër konsiderohet juridikisht i pavlefshëm.
3. Strukturat përkatëse ndalohen të zbatojnë ose referojnë ndonjë dispozitë të urdhrit të anuluar.
4. Ngarkohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe strukturat përkatëse të marrin masat përkatëse për zbatimin e menjëhershëm të këtij urdhri dhe pastrimin e çdo pasojë të pavlefshme administrative.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Jaho ÇABA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 966/ prot.

Gjirokastër, më 09.06. 2025

URDHËR

Nr. 84, datë 09.06.2025

" PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar , Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së znj. Jonilda Llupa me nr. 966 prot, datë 09.06.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, **znj. Jonilda Llupa** në pozicionin Specialiste për Projektet në Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **10. 06.2025** deri më **13.06.2025**
- 3 .Paraqitja në punë më **16.06.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. **Jahja CANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 967 Prot.

Gjirokastrë më, 09.06.2025

URDHËR

Nr. 85, datë 09, 06, 2025

PËR

**RIVLERËSIMIN E DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR DOKTORATURË SI PASOJË
E AMENDIMEVE NË RREGULLOREN E DOKTORATURËS**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të akteve nënligjore përkatëse, Vendim nr. 22, datë 06.05.2025 "Për shtyrjen e afatit të dorëzimit të çertifikatës së njohjes së gjuhës angleze për aplikantët në ciklin e tretë të studimeve doktoraturë në Edukim dhe Shkenca Humane, staf akademik të angazhuar me kohë të plotë në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë" si dhe në zbatim të ndryshimeve të miratuara në Rregulloren e Studimeve të Doktoraturës, të hyrë në fuqi me Vendimin e Senatit Akademik nr. 18, datë 09.06.2025, si dhe për të garantuar përputhshmërinë e procedurave me kuadrin e ri rregullator,

URDHËROJ:

1. Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore që ofron programin e studimit doktoraturë të marrë masat e nevojshme për rivlerësimin e dosjeve të kandidatëve për doktoraturë, të cilët janë në proces aplikimi, përzgjedhje ose janë pranuar sipas rregullores së mëparshme, por që nuk e kanë përfunduar ende procesin.
2. Rivlerësimi të kryhet në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren e re të Doktoraturës, duke vlerësuar përputhshmërinë e dokumentacionit dhe nevojën për plotësim apo përditësim të tij.
3. Personat përgjegjës të garantojnë zbatimin e këtij procesi në mënyrë të njëtrajtshme, transparente dhe në afatet e përcaktuara në rregullore.
4. Afati për përfundimin e rivlerësimit të të gjitha dosjeve është data 11.06.2025.
5. Fakulteti të raportojnë në Rektorat mbi ecurinë dhe rezultatet e këtij procesi brenda 5 ditëve pas përfundimit të afatit të sipërcituar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA



UK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1008 Prot.

Gjirokastrë, më 12 / 06 /2025

URDHËR

Nr. 86, datë 12.06.2025

PËR

**EMËRIMIN SPECIALIST PËR MËSIMDHËNIEN DHE KURRIKULAT ME KOHË TË
PLOTË DHE KOHËZGJATJE TË PACAKTUAR**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 pika 3, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si dhe neni 30 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1. **Z. Ermal Haloci**, deri më tani "Specialist për Mësimin dhe Kurrikulat" në Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, kalon definitive.
2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë me kohëzgjatje të pacaktuar.
3. Kategoria e pagës IV-2 .
4. Efektet financiare janë në vijueshmëri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1016 Prot

Gjirokastër, më 13.06.2025

URDHËR

Nr. 87, datë 13.06 2025

PËR

LEJIMIN E STUDENTËVE PËR SHLYERJEN E PROVIMEVE

Në mbështetje të nenit 39 pika 12, neni 98 pika 1, gërma b të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 30, pika 2; të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Eqrem Çabej", neni 21, pika 1; si dhe për të siguruar një proces të rregullt dhe të drejtë provimesh për vitin akademik 2024–2025,

URDHËROJ:

- Të gjithë studentët e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër të cilët janë në vitin e fundit të studimeve dhe që pritet të diplomohen në përfundim të këtij sezoni provimesh, lejohen të shlyejnë të gjitha provimet e prapambetura për vitin akademik 2024–2025.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet të gjitha strukturave përkatëse brenda Universitetit.

REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1043 Prot.

Gjirokastrë më 23.06.2025

URDHËR

Nr. 88, datë 23, 06, 2025

PËR

HEQJEN E MASËS DISIPLINORE "VËREJTJE ME SHKRIM"

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të akteve të brendshme rregullative të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, duke marrë në konsideratë faktin se që nga vendosja e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", me vendimin nr. 02, dhe nr. 790. prot datë 12.05.2025, punonjësja znj. Kaltrina Meleqi, me detyrë Specialiste Protokolli, ka ushtruar funksionin e saj me përkushtim, përgjegjshmëri dhe korrektësi, pa shënuar shkelje të mëtejshme të detyrimeve të punës apo sjellje të papërshtatshme, dhe me qëllim nxitjen e një klime pozitive institucionale dhe motivuese në marrëdhëniet e punës,

URDHËROJ:

1. Të hiqet masa disiplinore "Vërejtje me shkrim", e vendosur ndaj znj. Kaltrina Meleqi, me funksion Specialiste Protokolli pranë Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore në Drejtorinë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, etike dhe institucionale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e brendshme rregullative të institucionit.
2. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore të pasqyrojnë këtë ndryshim në dosjen personale të punonjësës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet punonjësës për dijeni.

REKTOR

Prof. Dr. Jahor ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1078 Prot.

Gjirokastrë më, 25.06.2025

URDHËR

Nr. 89, datë 25, 06, 2025

PËR

HEQJEN E MASËS DISIPLINORE "VËREJTJE ME SHKRIM"

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të akteve të brendshme rregullative të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, duke marrë në konsideratë faktin se që nga vendosja e masës disiplinore "Vërejtje me shkrim", me urdhrin nr. 04, datë 02.06.2025, punonjësja znj. Florinda Bano, me detyrë sekretare mësimore në Fakultetin Ekonomik, ka ushtruar funksionin e saj me përkushtim, përgjegjshmëri dhe korrektësi, pa shënuar shkelje të mëtejshme të detyrimeve të punës apo sjellje të papërshtatshme, dhe me qëllim nxitjen e një klime pozitive institucionale dhe motivuese në marrëdhëniet e punës,

URDHËROJ:

1. Të hiqet masa disiplinore "Vërejtje me shkrim", e vendosur ndaj znj. Florinda Bano, me funksion sekretare mësimore në Fakultetin Ekonomik, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, etike dhe institucionale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe aktet e brendshme rregullative të institucionit.
2. Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore të pasqyrojnë këtë ndryshim në dosjen personale të punonjësës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet punonjësës për dijeni.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1079 Prot.

Gjirokastrë më, 25 . 06 .2025

URDHËR

Nr. 90 , datë 25 , 06 , 2025

PËR

PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Në zbatim të nenit 141, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", si dhe pas verifikimit të dokumentacionit personal dhe të dhënave ligjore për punonjësen Zj. Violeta Serjani, e punësuar pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe ka përfituar më parë shtyrje të afatit të kontratës së punës,

URDHËROJ:

1. Marrëdhënia e punës me punonjësen Zj. Violeta Serjani përfundon me datë 30.06.2025 për shkak të përmbushjes së moshës për pension pleqërie.
2. Punonjësja Zj. Violeta Serjani ka përfituar më parë shtyrje të njëpasnjëshme të afatit të kontratës së punës pas mbushjes së moshës për pension pleqërie, duke vijuar detyrën me përgjegjësi dhe korrektësi. Duke qenë se marrëdhënia e punës përfundon në një periudhë intensive dhe procesi i dorëzimit të detyrës kërkon angazhim të plotë, shfrytëzimi fizik i ditëve të lejes vjetore të mbetura nuk është i mundur. Në këto kushte, në përputhje me nenin 94, pika 5, të Kodit të Punës, ditët e pashfrytëzuara të lejes vjetore do të kompensohen në vlerë monetare dhe do të pasqyrohen në llogaritë përfundimtare të likuidimit financiar.
3. Punonjësja duhet të përmbyllë në kohë procesin e dorëzimit të detyrës dhe mjeteve të punës, në bashkëpunim me komisionin e dorëzimit.

- a. Nëse procesi nuk përmbyllet brenda datës 30.06.2025, atëherë punonjësja do të jetë e detyruar të kryejë dorëzimin pas përfundimit të marrëdhënies së punës, pa shpërblim financiar, brenda 5 ditëve pune, në përputhje me rregullat e institucionit.
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të kryej procedurat përkatëse.

Ky urdhër i komunikohet punonjësit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Duke falënderuar për bashkëpunimin dhe kontributin shumëvjeçar të dhënë në institucion, i urojmë suksese në këtë fazë të re të jetës.

REKTOR

Prof. Dr Jaho ÇANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1111/ prot.

Gjirokastrë, më 07.07. 2025

URDHËR

Nr. 91, datë 07.07.2025

“ PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR ”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së znj. Jonilda Llupa me nr. 1111 prot, datë 07.07.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, **znj. Jonilda Llupa** në pozicionin Specialiste për Projektet në Sektorin e Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **11. 07.2025 – 18.07.2025**
- 3 .Paraqitja në punë më **21.07.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho ÇANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1121 Prot.

Gjirokastrë më, 07.07.2025

URDHËR

Nr. 92, datë 07, 07, 2025

PËR

NGRITJE NË DETYRË

Mbështetur në nenin 21 të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 39, pika 5 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit nr. 325, datë 31.5.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"; nenit 30, pika 1, gërma k, të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë si dhe Rregullores së Brendshme të Universitetit për të siguruar zhvillimin dhe funksionimin e pandërprerë të veprimtarisë administrative në institucion,

URDHËROJ:

1. Nga data 07.07.2025, znj. Alketa Rami, aktualisht e emëruar në detyrën "Specialiste për Kurrikulën dhe procesin mësimor", ngrihet në detyrë dhe emërohet "Përgjegjës i Sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë" pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brëndshëm, Marrëdhënive me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.
2. Ngritja në detyrë realizohet duke ruajtur të drejtën e pagës përkatëse sipas pozicionit të ri.
3. Ushtrimi i kompetencave administrative fillojnë nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Brëndshëm,

Marrëdhënie me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, për zbatimin e këtij urdhri dhe për përditësimin e dokumentacionit administrativ të punonjësit në përputhje me ndryshimin e detyrës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i komunikohet punonjësës.

REKTOR

Prof. Dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1134 prot.

Gjirokastër, më 09.07. 2025

U R D H Ë R

Nr. 93, datë, 09.07. 2025

P Ë R

**NGRITJEN E GRUPEVE TË PUNËS PËR PROCESIN E PËRLLOGARITJES SË PIKËVË,
APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT TË STUDENTËVE TË RINJ PËR VITIN AKADEMIK
2025-2026 , PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NË
UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ".**

Në zbatim të udhëzimit nr. 12, datë 30.06.2023 " Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar dhe Urdhërit të Përbashkët të QSHA dhe Qendrës Ndërinstitucionale Rrjetit Akademik Shqiptar, nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026, si dhe propozimeve të Njesisë Kryesore FESHSH nr. 127 prot, datë 08.07.2025 , Njesisë Kryesore FE nr. 70 prot, datë 02.07.2025, dhe Njesisë Kryesore FSHN nr. 75, datë 04.07.2025;

URDHËROJ ;

1. Ngritjen e grupeve të punës në rang institucional, për procesin e përlogaritjes së pikëve për aplikantët në programet e ciklit të parë dhe programeve me karakter profesional. (sipas shtojcës bashkëlidhur).
2. Ngritjen e grupeve të punës në rang institucional, për procesin e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj në të gjitha programet e studimit për ciklin e parë, ciklin e dytë, programeve të dyta të studimit dhe transferimeve të studimeve. (sipas shtojcës bashkëlidhur).

3. Mbikëqyrja e gjithë procesit të regjistrimit dhe aplikimit për pranimet e studentëve të rinj do të bëhet nga Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, në UGJ znj. Klaviona Dudumi.
4. Rikthimi në punë i grupit të punës për procesin e përlogaritjes së pikëve të aplikantëve në programet e ciklit të parë dhe programet me karakter profesional do të jetë data 21.08.2025.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1140 Prot.

Gjirokastrë më, 09.07.2025

URDHËR

Nr. 94, datë 09.07.2025

PËR

**NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE FINANCIARE, BAZUAR NË PËRFUNDIMIN
E KONTRATËS ME AFAT TË CAKTUAR PAS MBUSHJES SË MOSHËS PËR
PENSION PLEQËRIE**

Në zbatim të nenit 141, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", si dhe pas verifikimit të dokumentacionit personal dhe të dhënave ligjore për punonjësin Z. Adrian Kurti, i punësuar pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës në pozicionin "Laborant" i cila ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe ka përfituar më parë shtyrje të afatit të kontratës së punës,

URDHËROJ:

1. Marrëdhënia e punës me punonjësin Z. Adrian Kurti përfundon me datë 30.09.2025 për shkak të përmbushjes së moshës për pension pleqërie.
2. Punonjësi Z. Adrian Kurti ka përfituar më parë shtyrje të njëpasnjëshme të afatit të kontratës së punës pas mbushjes së moshës për pension pleqërie, duke vijuar detyrën me përgjegjësi dhe korrektësi. Duke qenë se marrëdhënia e punës përfundon në një periudhë intensive, në përputhje me nenin 94, pika 5, të Kodit të Punës, ditët e pashfrytëzuara të lejes vjetore do të kompensohen në vlerë monetare dhe do të pasqyrohen në llogaritë përfundimtare të likuidimit financiar.
3. Punonjësi duhet të përmbyllë në kohë procesin e dorëzimit të detyrës dhe mjeteve të punës.
 - Nëse procesi nuk përmbyllet brenda datës 06.10.2025, atëherë punonjësi do të jetë e detyruar të kryejë dorëzimin pas përfundimit të marrëdhënies së punës, pa shpërblim financiar, brenda 5 ditëve pune, në përputhje me rregullat e institucionit.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të kryej procedurat përkatëse.

Ky urdhër i komunikohet punonjësit dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1141 Prot.

Gjirokastrë më, 09.07.2025

URDHËR

Nr. 95, datë 09.07.2025

PËR

**NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE FINANCIARE, BAZUAR NË PËRFUNDIMIN
E KONTRATËS ME AFAT TË CAKTUAR PAS MBUSHJES SË MOSHËS PËR
PENSION PLEQËRIE**

Në zbatim të nenit 141, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Vendimi Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për Statusin dhe Trajtimin e Veçantë të Personelit Akademik" si dhe pas verifikimit të kontratës së punës me kohëzgjatjetë caktuar Z.Jani Jani, me pozicion Personel Akademik pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore i cila ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe ka përfituar më parë shtyrje të afatit të kontratës së punës,

URDHËROJ:

1. Të ndërpriten marrëdhëniet financiare dhe çdo detyrim financiar i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ndaj z. Jani Jani, me funksionin Personel Akademik pranë FESHSH, më datë 30.09.2025, për shkak të përfundimit të kontratës me afat të caktuar, e lidhur pas përfitimit të pensionit të pleqërisë.
2. Punonjësi duhet të përmbyllë në kohë procesin e dorëzimit të detyrës dhe mjeteve të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të kryej procedurat përkatëse.

Ky urdhër i komunikohet punonjësit dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Jaho ÇABA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1142 Prot.

Gjirokastrë më, 09.07.2025

URDHËR

Nr. 96, datë 09.07.2025

PËR

**NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE FINANCIARE, BAZUAR NË PËRFUNDIMIN
E KONTRATËS ME AFAT TË CAKTUAR PAS MBUSHJES SË MOSHËS PËR
PENSION PLEQËRIE**

Në zbatim të nenit 141, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Vendimi Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për Statusin dhe Trajtimin e Veçantë të Personelit Akademik" si dhe pas verifikimit të kontratës së punës me kohëzgjatjetë caktuar Zj. Zamira Kote, me pozicion Personel Akademik pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore e cila ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe ka përfituar më parë shtyrje të afatit të kontratës së punës,

URDHËROJ:

1. Të ndërpriten marrëdhëniet financiare dhe çdo detyrim financiar i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ndaj znj. Zamira Kote, me funksionin Personel Akademik pranë FESHSH, më datë 30.09.2025, për shkak të përfundimit të kontratës me afat të caktuar, e lidhur pas përfitimit të pensionit të pleqërisë.
2. Punonjësja duhet të përmbyllë në kohë procesin e dorëzimit të detyrës dhe mjeteve të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të kryej procedurat përkatëse.

Ky urdhër i komunikohet punonjësit dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1143 Prot.

Gjirokastrë më, 09.07.2025

URDHËR

Nr. 97, datë 09, 07, 2025

PËR

**NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE FINANCIARE, BAZUAR NË PËRFUNDIMIN
E KONTRATËS ME AFAT TË CAKTUAR PAS MBUSHJES SË MOSHËS PËR
PENSION PLEQËRIE**

Në zbatim të nenit 141, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Vendimi Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për Statusin dhe Trajtimin e Veçantë të Personelit Akademik" si dhe pas verifikimit të kontratës së punës me kohëzgjatjetë caktuar Zj. Arjana Konomi, me pozicion Personel Akademik pranë Fakultetit Ekonomik e cila ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe ka përfituar më parë shtyrje të afatit të kontratës së punës,

URDHËROJ:

1. Të ndërpriten marrëdhëniet financiare dhe çdo detyrim financiar i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ndaj znj. Arjana Konomi, me funksionin Personel Akademik pranë FE, më datë 30.09.2025, për shkak të përfundimit të kontratës me afat të caktuar, e lidhur pas përfitimit të pensionit të pleqërisë.
2. Punonjësja duhet të përmbyllë në kohë procesin e dorëzimit të detyrës dhe mjeteve të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të kryej procedurat përkatëse.

Ky urdhër i komunikohet punonjësit dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1144 Prot.

Gjirokastrë më, 09.04.2025

URDHËR

Nr. 98, datë 09.04.2025

PËR

**NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIEVE FINANCIARE, BAZUAR NË PËRFUNDIMIN
E KONTRATËS ME AFAT TË CAKTUAR PAS MBUSHJES SË MOSHËS PËR
PENSION PLEQËRIE**

Në zbatim të nenit 141, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Vendimit Nr. 329, datë 12.4.2017 "Për Statusin dhe Trajtimin e Veçantë të Personelit Akademik" si dhe pas verifikimit të kontratës së punës me kohëzgjatjetë caktuar Zj. Majlinda Bobrati, me pozicion Personel Akademik pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore e cila ka mbushur moshën për përfitimin e pensionit të pleqërisë dhe ka përfituar më parë shtyrje të afatit të kontratës së punës,

URDHËROJ:

1. Të ndërpriten marrëdhëniet financiare dhe çdo detyrim financiar i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ndaj znj. Majlinda Bobrati, me funksionin Personel Akademik pranë FESHSH, më datë 30.09.2025, për shkak të përfundimit të kontratës me afat të caktuar, e lidhur pas përfitimit të pensionit të pleqërisë.
2. Punonjësja duhet të përmbyllë në kohë procesin e dorëzimit të detyrës dhe mjeteve të punës.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare të kryej procedurat përkatëse.

Ky urdhër i komunikohet punonjësit dhe hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇANA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORAT**

Nr. 1146 Prot.

Gjirokastrë, më 09.07/2025

URDHËR

Nr. 99, datë 09.07.2025

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR VLERËSIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË STUDENTËVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË
MOBILITETE NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39 dhe neni 93, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 30, Thirrjes për aplikime për bursë mobiliteti për studim për studentët e programit të studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm" në kuadër të programit Erasmus+, Nr. 723 Prot., datë 25.04.2025, Thirrjes për bursë studimi për student në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA171 International Credit Mobility, Nr. 1124 Prot., datë 07.07.2025, Thirrjes për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ në Universitetin Mesdhetar të Kretës, Nr. 1123 Prot., datë 07.07.2025, dhe Marrëveshjeve të nënshkruara me Universitetet respektive,

URDHËROJ

1. Ngritjen e Komisionit *ad hoc* për vlerësimin e dokumentacionit të studentëve që do të përfshihen në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ për programin e studimit Bachelor në "Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm", me këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------------|----------|
| • Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| • MSc. Lutfi Gaba | Anëtar |
| • Irma Gjollëshi | Anëtare |

UK

2. Ngritjen e Komisionit *ad hoc* për vlerësimin e dokumentacionit të studentëve që do të përfshihen në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ për programin e studimit Bachelor në “Menaxhim Digjital”, me këtë përbërje:

- | | |
|-------------------------------|----------|
| • Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| • Prof. asoc. Ilirjana Zyberi | Anëtar |
| • Irma Gjollëshi | Anëtare |

3. Ngritjen e Komisionit *ad hoc* për vlerësimin e dokumentacionit të studentëve që do të përfshihen në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+ për programin e studimit Bachelor në “Infermieri të Përgjithshme”, me këtë përbërje:

- | | |
|-----------------------------|----------|
| • Prof. asoc. Merita Isaraj | Kryetare |
| • Prof. asoc. Sadik Malo | Anëtar |
| • Irma Gjollëshi | Anëtare |

4. Këto komisione do të jenë përgjegjëse për shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët e interesuar për mobilitet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e komisioneve të përmendura në pikat 1,2,3.

REKTORI

Prof. dr. Jahë CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1154 Prot

Datë 10/07 2025

URDHËR

Nr. 100, datë 10.07.2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT AD-HOC PËR DISA AMENDIME NË
RREGULLOREN E UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 39 pika 12; Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej", neni 30 pika 1;

URDHËROJ

1. Ngritjen e komisionit "ad-hoc" për disa ndryshime në Rregulloren e Universitetit. Komisioni me këtë përbërje:
 - a. Prof. Dr. Gëzim Sala - Kryetar
 - b. Prof. Asoc. Valbona Duri - Anëtar
 - c. Prof. Asoc. Lorenc Koçiu - Anëtar
 - d. Prof. Asoc. Sadik Malo - Anëtar
 - e. Borana Lelaj (Juriste) - Anëtar

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTOR

Prof. Dr. Jaho Cana



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1161 prot.

Gjirokastrë, më 11.07. 2025

URDHËR

Nr. 101, datë 11.07.2025

" PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së zj. Matilda Feruni me nr. 1161 prot, datë 11.07.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025 zj. **Matilda Feruni** në pozicionin Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **14.07.2025.**
- 3 .Paraqitja në punë **15. 07. 2025.**
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1162 Prot.

Gjirokastrë, më 11 / 07 /2025

URDHËR

Nr. 102, datë 11.07.2025

PËR

SHTYRJE TË AFATIT TË KONTRATËS

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë" i përditësuar neni 140 pika 1, gërma b, neni 150, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Satutit të Universitetit "Eqerem Çabej" neni 30 pika 2 Vendim nr. 422, datë 26.6.2024 për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit Të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetëse dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike",

URDHËROJ:

1. **Z. Aristomen Mandi** deri më tani në detyrë "Teknik i mesëm për shërbimet e rrjetit" në Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, Promovimit dhe Inovacionit pranë Drejtorisë së kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit në Universitetin "Eqerem Çabej" Gjirokastrë, i shtyhet afati i kontratës së punës.
2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë 6 (gjashtë) muaj, me kohë të pjesshme (4 orë në ditë) nga data 15.07.2025 deri më datë 14.01.2026.
3. Kategoria e pagës do të jetë sipas Kreut I/1 me emërtesë "Teknik i mesëm për shërbimet e rrjetit".
4. Klasa V, me pagë mujore 42 800 (dyzetë e dy mijë e tetëqindë) lekë.
5. Efektet financiare në vijueshmëri.

Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. Jahor ÇANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1200 Prot.

Gjirokastrë, më 16.07/2025

URDHËR

Nr. 103, datë 16.07.2025

PËR

**NGRITJEN E KOMISIONIT AD HOC PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KANDIDATURAVE PËR POZICIONIN PERSONEL AKADEMIK ME KOHË TË
PLOTË DHE KOHËZGJATJE TË CAKTUAR PRANË NJËSISË BAZË TË
KONTABILITET - FINANCËS NË FAKULTETIN EKONOMIK**

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Kreu VI, "Personeli i institucioneve të arsimit të lartë" neni 64 "Punësimi i personelit akademik", Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 56 "Punësimi i personelit akademik", Rregullores për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej" si dhe shkresës me nr.78/1 Prot. datë, 15/07/2025 "Përzellje propozimi për anëtarët e komisionit Ad-hoc për shqyrtimin e dosjeve dhe shpalljen e aplikantëve fitues në konkursin e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar në Njësine bazë të Kontabilitet Financës" për vitin akademik 2025-2026.

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit ad-hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për 1 (një) vend të lirë pune, "Lektor/Asistent-Lektor", personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar pranë Njesisë Bazë të Kontabilitet-Financës, në Fakultetin e Ekonomik, caktohen si anëtarë komisioni i mëposhtëm:

- Prof.asoc. Lorenc Koçiu	Dekan i FE	Kryetar
- Prof.dr. Gëzim Sala	Zv/ Rektor	Anetar
- Prof.asoc.Drita Luzo	Përgj. Njesisë Bazë	Anetar
- Dr.Robert Çelo	Anëtar i Njesisë Bazë	Anetar
- Dr.Zamira Veizi	Anëtar i Njesisë Bazë	Anetar
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri anëtarët e komisionit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. JAHORANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1207 Prot.

Gjirokastrë, më 21.07/2025

URDHËR

Nr. 104, datë 21.07.2025

PËR
RIKTHIMIN NË PUNË TË PËRKOHSHËM
NGA LEJA VJETORE

Në mbështetje të ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në funksion të nevojës për përmbushjen e detyrimeve institucionale dhe angazhimeve të papritura, referuar Urdhërit 103, datë 16.07.2025 "Për ngritjen e komisionit ad hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për pozicionin personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar pranë Njesisë Bazë të Kontabilitet Financës në Fakultetin Ekonomik".

URDHËROJ:

1. Rikthimin në punë më datë 23.07.2025 të personelit akademik si më poshtë:

Prof.asoc. Lorenc Koçiu
Prof.dr. Gëzim Sala
Prof.asoc.Drita Luzo
Dr.Robert Çelo
Dr.Zamira Veizi

2. Pas përfundimit të angazhimit, personeli akademik të vijojnë pjesën e mbetur të lejes.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhëri, Dekani i Fakultetit Ekonomik dhe Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR
Prof. Dr. JAHO CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1219/ prot.

Gjirokastër, më 22.07. 2025

URDHËR

Nr. 105, datë 22.07.2025

" PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së znj. Irma Gjolleshi me nr. 1219 prot, datë 22.07.2025

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, znj. **Irma Gjolleshi** në pozicionin Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit Ndërkombëtar, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor pranë Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **28.07.2025**.
- 3 .Paraqitja në punë **29.07.2025**.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtorja Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jaho CANA



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1220 Prot.

Gjirokastrë, më 23 / 07 / 2025

URDHËR

Nr. 106, datë 23 . 07 . 2025

PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE NË KOMISIONIN AD HOC PËR SHQYRTIMIN DHE
VLERËSIMIN E KANDIDATURAVE PËR POZICIONIN "SPECIALIST PËR KURRIKULAT
DHE PROCESIN MËSIMOR"

Në mbështetje të, Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 66 pika 3 "Punësimi i personelit akademik", neni 57, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" "Punësimi personelit ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ" neni 8 të Rregullores "Për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej"

URDHËROJ:

1. Ngritjen e komisionit ad hoc për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin "Specialist për Kurrikulat dhe Procesin Mësimor", në Sektorit të Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë, pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, si mëposhtë:

- Zv. Rektor për Koordinimin Ndërkombëtar dhe Kërkimin Shkencor Prof.asoc Merita Isaraj (Kryetar)
- Klaviona Dudumi (Anëtare)
- Borana Lelaj (Anëtare)
- Alketa Rami (Anëtare)
- Valentina Shehu (Anëtare)

2. Ky komision do të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidaturat sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.dr. Jaho Çana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
R E K T O R I

Nr. 1272 prot.

Gjirokastrë, më 27.08. 2025

U R D H Ë R

Nr. 107, datë, 27.08. 2025

P Ë R

**PREZENCËN NË PUNË GJATË DITËVE TË PUSHIMIT ZYRTAR, TË GRUPIT TË PUNËS
PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE TË RINJ NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË
DHE PROGRAMEVE ME KARAKTER PROFESIONAL PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026.**

Mbështetur në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin nr. 12, datë 30.06.2023 "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar, Urdhërit të Përbashkët të QSHA dhe Qendrës Ndërinstitucionale Rrjetit Akademik Shqiptar, nr. 157, datë 03.06.2025 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2025-2026 dhe në vijim të Urdhërit të Rektorit Rektorit nr. 93, datë 09.07.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për procesin e përllogaritjes së pikëve, aplikimit dhe regjistrimit të studentëve të rinj për vitin 2025-2026".

U R D H Ë R O J ;

1. Grupi i punës për procesin e regjistrimeve të reja për vitin akademik 2025-2026, do të zbatojë kalendarin e procedurat e regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë. (sipas urdhërit të përbashkët nr. 157, datë 03.06.2025 të QSHA-së dhe RASH-it).
2. Prezenca e grupit të punës do të jetë edhe për ditët e shtuna dhe të diela sipas orarit zyrtar të punës.
3. Drejtori i DSKMT-së, do të mbajë prezencë ditore për grupin e punës dhe do tja përcjellë një kopje Rektorit të UGJ-së dhe Administratorit të UGJ-së

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

R E K T O R

Prof. Dr. Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1293/ prot.

Gjirokastrë, më 01.09. 2025

URDHËR

Nr. 103, datë 01.09.2025

" PËR DHËNIE LEJE PA TË DREJTË PAGE"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, vendim Nr. 329, datë 12.4.2017 " Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik" neni 19, Statutin e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Rregullores se Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë si dhe kërkesës së znj. **Alma Kore** me Nr.1293 .prot. datë 01.09.2025

URDHËROJ:

1. T'i jepet leje pa të drejtë page znj. **Alma Kore**, në pozicionin personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njesisë Bazë të Administrimit Publik pranë Fakultetit Ekonomik.

2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datën **02.09.2025**.

3 .Paraqitja në punë **03.09.2025**.

4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. **Jahë CANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1294 Prot.

Gjirokastrë, më. 02 / 09 /2025

URDHËR

Nr. 109, datë 02 . 09 .2025

PËR

PËRFUNDIMIN E VITIT SABATIK TË PERSONELIT AKADEMIK

Në mbështetje të nenit 63 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë neni 53, Rregullores së Brendshme dhe Urdhërit nr.1212, datë 23.08.2024 "Për mriatimin e vitit sabatik për personelin akademik";

URDHËROJ:

1. Të përfundojë zyrtarisht periudha e vitit sabatik për Dr. Belinda Xarba, me detyrë Lektore pranë Fakultetit Ekonomik , Departamenti i Kontabilitet - Financës, në datën 01.09.2025.
2. Nga data 02.09.2025, Znj. Belinda Xarba të rikthehet në detyrën e saj të mëparshme si (pozicioni i plotë) pranë Fakultetit Ekonomik, Departamenti i Kontabilitet - Financës, duke rifilluar detyrimet e plota akademike, mësimore dhe kërkimore, sipas ngarkesës dhe dispozitave përkatëse ligjore e institucionale.
3. Dr. Belinda Xarba detyrohet të dorëzojë raportin përfundimtar të punës së kryer me rezultatet e përparimit akademik.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore për pasqyrimin e këtij ndryshimi në dokumentacionin personal dhe financiar të punonjësit.
5. Ngarkohet Dekanati i Fakultetit Ekonomik për marrjen e të gjitha masave organizative lidhur me ngarkesën akademike të Znj Belinda Xarba, në përputhje me Rregulloren e Fakultetit dhe vendimet e organeve drejtuese të Universitetit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr. Jaho Çapa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1295 Prot.

Gjirokastrë, më 02/09/2025

URDHËR

Nr. 110, datë 02.09.2025

PËR

EMËRIMIN E SPECIALISTES PËR KURRIKULAT DHE PROCESIN MËSIMOR ME
KOHËZGJATJE TË CAKTUAR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) i përditësuar, Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 66 pika 3, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si dhe neni 30 të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej",

URDHËROJ:

1. **Znj.Dorina Koko**, emërohet "Specialiste për Kurrikulat dhe Procesin Mësimor" pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
2. Kohëzgjatja e kontratës së punës do të jetë 3 muaj, kjo si periudhë do të konsiderohet edhe si kohë prove.
3. Kategoria e pagës IV-2 .
4. Efektet financiare dhe ushtrimi i kompetencave administrative fillojnë më datë 04.09.2025.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Administratori, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jaho ÇANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1301/ prot.

Gjirokastrë, më 04.09. 2025

URDHËR

Nr. 111, datë 04.09.2025

“ PËR DHËNIE LEJE PA TË DREJTË PAGE”

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave,” Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore” si dhe kërkesës së znj. Etleva Hysaj me nr. 1301 prot, datë 04.09.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet leje pa të drejtë page **znj. Etleva Hysaj** personel akademik me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të pacaktuar në Njësinë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat **09.09.2025** deri më **10.09.2025**.

3 .Paraqitja në punë **11.09.2025**.

4.Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë!

REKTOR

Prof.Dr. **Jaho CANA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1306 Prot.

Gjirokastrë, më. 08.09 /2025

URDHËR

Nr. 112 , datë 08 , 09 , 2025

PËR

KOMANDIM TË PËRKOHSHËM NË NJË POZICION TJETËR PUNE

Në mbështetje të nenit 34 të Kodit të Procedurave Administrative, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 39 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, Rregullores së Universitetit dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi; si dhe duke marrë në konsideratë nevojën për garantimin e vijueshmërisë së punës dhe përmbushjen e detyrave funksionale të institucionit,

URDHËROJ:

1. Znj. Fabiola Sinani, me detyrë Sekretare e Dekanit pranë Fakultetit Ekonomik, ngarkohet përkohësisht me ushtrimin e detyrave shtesë që lidhen me pozicionin e punonjësës Znj. Florinda Bano, e cila ndodhet në leje mjekësore, për periudhën nga 08.09.2025 dhe deri në rikthimin e saj në punë.
2. Detyrat shtesë do të kryhen në bashkëpunim me drejtuesin e njësisë përkatëse dhe pa cenuar përmbushjen e detyrave të rregullta të punës.
3. Gjatë ushtrimit të detyrës në pozicionin ku komandohet, punonjësi:
 - ruan statusin dhe marrëdhënien e punës me institucionin;
 - gëzon të drejtat financiare dhe administrative sipas pagës në pozicionin e aktual.
4. Ngarkohen Drejtorja Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, Fakulteti Ekonomik si dhe Kryesekretari i Universitetit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof.dr. Jaho Cama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1307 Prot.

Gjirokastër, më 08 / 09 / 2025

URDHËR

Nr. 113, datë 08.09.2025

PËR
EMËRIM PERSONELI AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË
DHE KOHËZGJATJE TË CAKTUAR

Mbështetur në Ligjin Nr. 80 / 2015, datë 22. 07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Kreu VI, nenet 57, 59, 64, në vendimin nr.329, datë 12.04.2017" Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik " pika 7, në Statutin e U.GJ-së, Neni 56, në "Rregulloren e procedurave të punësimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik" neni 8, si dhe në procesverbalin e datës 23.07.2025, nga komisioni ad-hoc për shqyrtimin e kandidaturës për 1 (një) vend të lirë për personel akademik "Asistent-Lektor" me angazhim me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar në Njesinë Bazë të Kontabilitet Financës, pranë Fakultetit Ekonomik me propozim të Përgjegjësit të Njesisë Bazë me shkresë datë, 27.06.2025, përcjellë Rektorit nga Dekani FE me shkresë nr. 67 prot. datë 27.06.2025 ;

U r d h ë r o j :

1. Emërimin e **Znj. Fatime Beqo**, në pozicionin "Asistent - Lektor" me angazhim me kohë të plotë dhe me kohëzgjatje të caktuar në Njesinë Bazë të Kontabilitet Financës, pranë Fakultetit të Ekonomik.
2. Kontrata e punës do të jetë me kohë të plotë dhe kohëzgjatje të caktuar nga data, **10.09.2025** deri më **09.09.2026**.
3. Pagesa do të jetë në bazë të Vendimit të KM-së Nr.748, datë 11.06.2009 " i ndryshuar "Për trajtimin me pagë me shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", nga kategoria "Asistent- Lektor ".
4. Efektet financiare fillojnë më datë, **10.09.2025**.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Administratori, Dekani i Fakultetit Ekonomik, Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.dr. Jaho CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr 1312 Prot.

Gjirokastrë më, 08.09.2025

URDHËR

Nr. 114, datë 08, 09, 2025

PËR

LIRIM NGA DETYRA PËR SHKAK TË DORËHEQJES

Në zbatim të nenit 144, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 92 e vijues, ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 39, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë dhe dispozitave përkatëse të Rregullores së Përgjithshme të Universitetit; kërkesës së paraqitur me shkrim nga zj. Belinda Xarba, nr. 1311 prot, datë 08.09.2025, për dorëheqje nga detyra e saj si Lektore pranë Fakultetit Ekonomik

URDHËROJ:

1. Lirimin nga detyra të Znj. Belinda Xarba, me detyrë Lektore pranë Fakultetit Ekonomik për shkak të dorëheqjes së paraqitur me kërkesën e saj të datës 08.09.2025.
2. Punonjësi gëzon të drejtën të pajiset me vërtetimin e vjetërsisë në punë dhe dokumentacionin shoqërues nga Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Marrëdhëniet institucionale i ndërpriten më datë 08.09.2025.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore, për pasqyrimin e ndryshimeve në regjistrin e punësimit dhe për përgatitjen e dokumentacionit përkatës të mbylljes së marrëdhënies së punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof. Dr. Jahid CANA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1325 prot.

Gjirokastrë, më 10.09.2025

URDHËR

Nr. 115, datë, 10.09.2025

PËR

**MONITORIMIN E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE NGA PËRFAQËSUES TË ZYRËS
SË FINANCËS**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; Nenit 89 pika c, të Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastrë. Në zbatim të rregullores së brendshme të institucionit, dhe në kuadër të sigurimit të një procesi transparent dhe të rregullt gjatë sezonit të provimeve, si dhe për të garantuar respektimin e detyrimeve financiare të studentëve ndaj institucionit,

URDHËROJ:

1. Përfaqësues të caktuar nga Zyra e Financës do të jenë të pranishëm në ambientet ku zhvillohen provimet për sezonin e vjeshtës, me qëllim monitorimin e:

Statusit financiar të studentëve pjesëmarrës në provim;

Pagesave të kryera për provimet e rregullta dhe/ose të mbartura;

Çdo procedure tjetër që lidhet me kontrollin financiar gjatë këtij procesi.

2. Stafi përkatës përgjegjës për monitorim:

Erjela Dhromaj, Parashqevi Kalanderi, Adelina Hoxha, Ornela Kareco.

3. Monitorimi do të zhvillohet për të gjitha provimet që organizohen gjatë sezonit të vjeshtës, sipas kalendarit zyrtar të provimeve të publikuar nga fakultetet përkatëse.

4. Të gjithë përgjegjësit e departamenteve dhe pedagogët janë të lutur të bashkëpunojnë plotësisht me përfaqësuesit e Financës gjatë procesit të zhvillimit të provimeve.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe është i vlefshëm deri në përfundimin e sezonit të provimeve të vjeshtës.

REKTORI

Prof.dr Jaho Çabej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 1328/ prot.

Gjirokastrë, më 10.09. 2025

URDHËR

Nr. 116, datë 10.09.2025

" PËR DHËNIE LEJE TË PUSHIMIT VJETOR"

Mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë i përditësuar, Vendimit nr. 530, datë 01.08.2024 " Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.568, datë 6.10.2021 të Këshillit të Ministrave," Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore" si dhe kërkesës së znj.Ornela Mera me Nr.1328 Prot, datë 10.09.2025.

URDHËROJ:

1. Ti jepet një pjesë e lejes së parashikuar për vitin 2025, znj.Ornela Mera në pozicionin Përgjegjëse e Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Bibliotekës Shkencore Institucionale, pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
- 2 .Kohëzgjatja e lejes do të jetë për datat 11.09.2025
- 3 .Paraqitja në punë 12.09.2025.
- 4 .Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Shërbimeve Universitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Jahë ÇANA

Rruga "Studenti" Lagja "18 Shtatori", Gjirokastrë 6001, Tel: 084263408
web: www.uogj.edu.al, email : rektori@uogj.edu.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1341 prot.

Gjirokastrë, më 12.09. 2025

URDHËR

Nr. 117, datë, 12.09. 2025

PËR

ORGANIZIMIN E MËSIMDHËNIES NË VITIN AKADEMIK 2025-2026

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 87 ; Statutit të universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 74 ; Urdhërit të MAS-it nr. 145, datë 14.04.2025 " Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2025 – 2026 në Institucionet e Arsimit të Lartë" :

URDHËROJ ;

1. Fillimin e vitit akademik 2025-2026 në datën **6 Tetor 2025** dhe mbarimin e tij në datën **25 Shtator 2026**.
2. Periudha 22 Dhjetor 2025 deri më 2 Janar 2026; do të jetë periudhë pushimesh për studentët dhe stafin akademik.
3. Njësitë bazë të hartojnë strukturën mësimore dhe miratojnë në Dekanatet përkatëse sipas semestrave.
4. Një kopje e strukturës mësimore depozitohet pranë Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm, Marrëdhënieve me Studentët dhe Teknologjisë së Informacionit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike dhe administrative të UGJ-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr Jaho CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORAT

Nr. 1344 Prot

Gjirokastrë më 12.09.2025

URDHËR

Nr. 118, datë 12.09.2025

PËR

KRIJIMIN E KOMISIONIT PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTËVE TË SIGURISË NË DIPLOMA

Në mbështetje të: Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 39 dhe 40; Udhëzimit nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar" kreu II, pika 2, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 23.

URDHËROJ:

1. Krijohet Komisioni i Përkohshëm për Përcaktimin e Elementëve të Sigurisë në Diploma të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, me këtë përbërje:
 - a) Prof. dr Gëzim Sala, Kryetar;
 - b) Prof. asoc Merita Isaraj, Anëtar;
 - c) Borana Lelaj, Anëtar;
 - d) Vladimir Belaj, Anëtar;
 - e) Valenina Shehu, Anëtar.
 2. Komisioni ka për detyrë:
 - Të shqyrtojë standardet ligjore dhe praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare mbi elementët e sigurisë në diploma;
 - Të propozojë elementë sigurie (vizuale, teknike dhe digjitale) për diplomat e Universitetit;
 3. Komisioni do të përfundojë punimet brenda afatit prej 3 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të kalojë për miratim në Senatin Akademik.
